



FinanceMission Heroes –

Që të mësohen kompetencat financiare duke luajtur

Të dashur prindër

Në Zvicër më shumë se një e katërta e moshës 18-24 vjeç jetojnë në ekonomi shtëpiake me prapambetje pagese.* Që të rinjtë të mos hyjnë në borxhe, ata duhet të mësojnë herët që të sillen në mënyrë të përgjegjshme me paratë dhe konsumin. Kështu që planet e reja mësimore për nxënëset dhe nxënësit e shkollave sekundarë përmbajnë edhe nxitjen e kompetencave financiare.

Prandaj shoqatat e arsimtarëve LCH dhe SER kanë zhvilluar lojën digjitale FinanceMission Heroes, të përkrahur nga Bankat Kantonale Zvicerane.

FinanceMission Heroes nuk është vetëm një lojë kompjuterike, por edhe një lojë serioze mësimi, e cila është realizuar nga ekspertë të profileve të ndryshme. Ajo edukon sjelljen e vetëdijshme me paratë dhe nevojat personale.

Për një herë nxënëset dhe nxënësit brenda mësimit kanë të drejtë të luajnë në kompjuter, sepse duke luajtur me FinanceMission Heroes ata mësojnë jo vetëm të përpilojnë një buxhet, të vlerësojnë vendimet e blerjes, të bëjnë dallimin midis kostove të blerjes dhe shpenzimeve që i pasojnë, por edhe shumë më tepër.

Megjithatë, loja merr vetëm një pjesë të vogël të kohës së mësimit. Edhe fletët e punës janë pjesë e ofertës mësimore të FinanceMission, në të cilat nxënëset dhe nxënësit mbartin dhe thellojnë përvojat e bëra gjatë lojës në jetën e tyre të përditshme. Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen tonë të internetit www.financemission.ch, në veçanti edhe te pyetjet dhe përgjigjet www.financemission.ch/faq.

Meqë ra fjala: Në "Best of Swiss Apps Awards 2016", FinanceMission Heroes fitoi medaljen e bronzit.

Ne gëzohemi, nëse edhe fëmija juaj mund të përfitojë nga kjo ofertë mësimore dhe përmes saj ta përmirësojë kompetencën e tij/e saj financiare.

Me respekt
Shoqata FinanceMission

Beat W. Zemp

President
President qendror
Lehrerinnen und Lehrer Schweiz LCH

Samuel Rohrbach

Anëtar i kryesisë
Syndicat des enseignants
romands SER

* Studim i Entit Federal për Statistikën